

REPUBLIKA E SHQIPËRISË



Shoqëria "ADRIATIKA BETON" Shpk

V E N D I M

I

ASAMBLESE SË JASHTËZAKONSHME TË ORTAKËVE TË SHOQËRISË "ADRIATIKA BETON" SHPK

Sot më datë 10. 05. 2004, në Selinë e Shoqërisë "Adriatika Beton" Shpk, të ndodhur në adresën : ish-NShN, Shkozë, Durrës, Shqipëri, zhvillohet mbledhja e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakëve të kësaj Shoqërie.

Shoqëria "Adriatika Beton" Shpk, është regjistruar si person juridik shqiptar, me Vendim Nr.29773, datë 30. 05. 2003, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, me seli të saj, në : Ish-NShN, Shkozë, Durrës, Shqipëri, dhe kapital themeltar të shoqërisë, në shumën 100 000 Lekë, me Ortak të Shoqërisë, Z. Ardian Muka që zotëron 30 % (tridhjetë përqind) dhe Z. Adrian Dulaku, që zotëron 70% (shtatëdhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë.

Me Vendimin Nr. 29773/1 datë 10. 05. 2004, të Gjyqtarit të Vetëm, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, është vendosur pranimi i kërkesë për emërimin e grupit të ekspertëve, të përbërë nga Vlerësuesja e Shkallës së Parë Zj.Yliana Dhozhi (Sejfo), me Nr. Liçense SVP 0017, datë 04. 07. 2000, dhe Ing. Z. Petrika Naço, me Nr. Liçense SVP 0040, datë 14. 07. 1998, Për ekspertimin, vlerësimin e kapitalit të shoqërisë dhe hartimi i aktit të ekspertimit, i cili tashmë ka evidetuar rritjen e kapitalit themeltar të Shoqërisë "Adriatika Beton" Shpk.

Asambleja e Jashtëzakonshme e Ortakëve të Shoqërisë "Adriatika Beton" Shpk, pasi dëgjoi relatimin e të Grupit të Ekspertëve dhe shqyrtoi dokumentacionin dokumentacionin përkatës, në përfundim, në unanimitet të plotë,

V E N D O S I :

1 - Miratimin e Aktit të Ekspertizës të kryer nga grupi i ekspertëve të përbërë nga Vlerësuesja e Shkallës së Parë Zj.Yliana Dhozhi (Sejfo), me Nr. Liçense SVP 0017, datë 04. 07. 2000, dhe Ing. Z. Petrika Naço me Nr. Liçense SVP 0040, datë 14. 07. 1998, ngarkuar nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, me Vendimin Nr.29773/1 datë 10. 05. 2004, për kryerjen e aktit të ekspertizës për rritjen e kapitalit të Shoqërisë "Adriatika Beton" Shpk.

2 - Rritjen e kapitalit themeltar, si kontribute në natyrë, të Shoqërisë "Adriatika Beton" Shpk, në shumën totale prej 1,025,000 USD (Njëmilion e njëzet e pesë mijë Dollarë Amerikan), sipas raportit 30%(tridhjetë përqind) Ardian Muka dhe 70 % (shtatëdhjetë përqind) Adrian Dulaku .

3 - Sa më sipër ky vendim dhe këto dokumenta do të depozitohen pranë Zyrës së Regjistrimit Tregëtar, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për t'u pasqyruar ndryshimet përkatëse në Statut dhe në kolonën e regjistrimit tregëtar.

ORTAKËT E SHOQËRISË "ADRIATIKA BETON" SHPK

Ardian MUKA

Ardian Muka



Adrian DULAKU

Adrian Dulaku

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 2724...REP.
Nr. 588...KOL.

V Ë R T E T I M

Sot, më datë 10/ 05/ 2004 (dymijë e katër), ditën e Hënë, përpara meje **Ruko Sako**, Notere pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, me adresë në Rrugën e "Durrësit", u paraqit personalisht :

Z. Ardian MUKA, shtetas shqiptar, lindur më 05. 08. 1967, në Durrës, Shqipëri, banues në adresën :
Lagjja Nr. 6, Rruga "Bashkimi" Nr. 65, Durrës, Shqipëri, mbajtes i pasaportës me Nr. QH 450959,
madhor dhe me zotësi të plote juridike për të vepruar.

2. **Z. Adrian DULAKU**, shtetas shqiptar, lindur më 05. 02. 1960, në Tiranë, Shqipëri, banues në
adresën : Rruga "Pjetër Bogdani" Nr. 24/4, Tiranë, mbajtes i pasaportës me Nr. 0362863, madhor me
zotësi të plotë juridike për të vepruar.

të cilët më deklaruan se dokumenti i bashkëngjitur këtij Vërtetimi është një Vendim i Asamblesë së
Jashtëzakonshme e Ortakëve të Shoqërisë "Adriatika Beton" Sh. P.K, i hartuar dhe i nënshkruar me vullnetin
e tyre të lirë dhe të plotë, dhe unë, noterja e vërtetoj nënshkrimin e tyre rregullisht sipas ligjit.



NOTERE

Ruko SAKO